

**STATUTI dhe AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË TREGTARE ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Ci.Sor” Sh.p.k**

**STATUTO E ATTO COSTITUTIVO
DELLA SOCIETA' COMMERCIALE A
RESPONSABILITA' LIMITATA
‘Ci.Sor’ s.r.l.**

**KREU I
*Pjesa e përgjithshme***

**CAPITOLO I
*Parte generale***

Ky statut dhe akt i themelimit dhe Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, rregullojnë marrëdhëniet midis ortakëve të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Ci.Sor” Sh.p.k.

Il presente statuto e atto costitutivo e la Legge n. 9901, del 14.04.2008, "Su commercianti e società commerciali", regola i rapporti tra i soci della società a responsabilità limitata “Ci.Sor” s.r.l.

KREU II
Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakëve

CAPITOLO II
Nome, forma, sede centrale, oggetto dell'attività, durata, filiali e uffici di rappresentanza, responsabilità dei soci

**NENI 1
*Emri***

**ARTICOLO 1
*Nome***

Shoqëria tregtare mban emrin “Ci.Sor” Sh.p.k.
Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

L'azienda di nome “Ci.Sor” s.r.l.
Il cambio del nome della società può essere effettuato solo su decisione dell'Assemblea Generale della società.

**NENI 2
*Forma***

**ARTICOLO 2
*Modulo***

Shoqëria tregtare “Ci.Sor” Sh.p.k. ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

La società commerciale “Ci.Sor” s.r.l.” ha la forma di una società a responsabilità limitata.

**NENI 3
*Zyra Qendrore***

**ARTICOLO 3
*Ufficio Centrale***

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Ci.Sor” Sh.p.k. do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njësia bashkiake nr.5 Rruga “Petro Korçari” ndërtesa nr.6

3.1 La società a responsabilità limitata “Ci.Sor” s.r.l. avrà sede in Albania, Il comune nr.5 Via ‘Petro Korçari’ edificio nr. 6 interno nr.5, appartamento nr.12,1022 Tirana.

hyrja nr.5 apartamenti nr. 12,1022.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

3.2 Il cambio della sede centrale della società può essere effettuato solo su decisione dell'Assemblea Generale della società.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt këto aktivitete:

- Menaxhimi, blerja, shitja, dhënia me qira e pronave të paluajtshme dhe ndërmjetësimi për shitje-blerje apo dhënie me qira të pronave të paluajtshme midis personave fizike, personave juridike private dhe publike. Çdo veprim tjetër i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme (real estate), vendase apo dhe të huaj, investim dhe tjetërsim.
- Hartimin e projekteve të vizibilitetit dhe zhvillimit të pasurive të paluajtshme.
- Asistence dhe konsulencë financiare në fushën e pasurive të paluajtshme.

Për realizimin e objektit të saj, shoqëria mund të blejë dhe/ose të marrë me qira pasuri të paluajtshme, të blejë kuota të kapitalit të shoqërive të tjera në Shqipëri ose shtete të tjera, të marrë me qira shoqëri shqiptare dhe të huaja, si dhe çdo veprimtari tjetër që e lejon ligji.

NENI 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “Ci.Sor” Sh.p.k do të jetë e pacaktuar që fillon nga data 11.06.2024.

ARTICOLO 4

Oggetto dell'attività

L'azienda ha come oggetto della propria attività:

- Gestione, acquisto, vendita, locazione di beni immobili e mediazione per compravendita o locazione di beni immobili tra persone fisiche, persone giuridiche private e pubbliche. Ogni altra attività legale relativo alle transazioni immobiliari, nazionali o esteri, di investimento e di alienazione.
- Redazione di progetti di visibilità e sviluppo immobiliare.
- Assistenza e consulenza finanziaria in materia di asset fluttuanti.

Per il raggiungimento del proprio oggetto sociale, la società potrà acquistare e/o condurre in locazione immobili, acquistare partecipazioni in altre società in Albania o in altri Stati, affittare aziende albanesi ed estere.

ARTICOLO 5

Durata

La durata dell'attività della società “Ci.Sor” s.r.l. sarà a tempo indeterminato che inizia da data 11.06.2024

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "Ci.Sor" Sh.p.k, mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

KREU III
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 8
Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1. Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Ci.Sor" Sh.p.k ", është 800.000 (teteqindmijë) lekë i gjithi i nënshkruar dhe i shlyer tërësisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë, përkatësisht;

- **Filippo Andreściani** (shtetas italian) i identifikuar me pasaportë italiane nr. YB3406666, lindur në Camerino (MC) Itali, më datë 31.03.1977, banues në Contrada Chiarino 10 Recanati, zotërues i një kuote në vlerën 800.000 (teteqind mije) lekë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9
Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

ARTICOLO 6
Filiali e Uffici di Rappresentanza

La società "Ci.Sor" " s.r.l. può aprire le sue filiali o uffici di rappresentanza all'interno o all'esterno del paese.

ARTICOLO 7
Responsabilità dei Soci

I soci sono responsabili e coprono personalmente le perdite della società fino alla parte restante dei contributi da loro sottoscritti.

CAPITOLO III
Capitale sociale e quote, aumento e diminuzione di capitale, trasferimento di quote di capitale

ARTICOLO 8
Capitale e Quote della Società

8.1. Il capitale della società a responsabilità limitata "Ci.Sor" s.r.l. è di 8.000,00 (otto mila) di ALL versato ed sottoscritto dal unico socio:

- **Filippo Andreściani** (cittadino italiano) identificato con pasaporto italiano nr. YB3406666, nato a Camerino (MC), Italia, nato il 31.03.1977, residente a Contrada Chiarino 10 Recanati, titolare di 1 quota equivalente al 100% del capitale sociale, pari a 800.000 ALL;

ARTICOLO 9
Aumento del Capitale della Società

9.1 Il capitale sociale della società può essere aumentato senza limiti, una o più volte, con decisione dell'Assemblea Generale.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

9.3 Ortaket kane te drejte te bejne financime ortaku per shoqerine ,qofte me perfitime dhe pa perfitime,te cilat mund te jene te ne raport jo te drejte me perqindjen e pjesmarrjes se tyre ne kapitalin e shoqerise.

NENI 10

Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

10.2 Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital, me përjashtim të rastit kur në bazë të ligjit ose të statutit Asambleja e Përgjithshme mund të vendosi ndryshe.

NENI 11

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

-Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet palëve.

-Transferimi i kuotave të ortakëve të shoqërisë brenda ortakërisë apo në drejtim të personave të tretë jashtë ortakërisë është i kushtëzuar në çdo rast nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.

-Ortaku përpara se t'i transferojë në çdo formë kuotat e veta një ortaku tjetër ekzistues brenda shoqërisë apo një personi tjetër jashtë saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht të gjithë ortakët ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe në mënyrë

9.2 In caso di aumento del capitale sociale della società, tutti i soci hanno diritto di sottoscrivere le quote del capitale aumentato in proporzione alla loro partecipazione al capitale.

9.3 I soci potranno effettuare dei finanziamenti alla società, sia fruttiferi che non fruttiferi, anche in misura non proporzionale alla partecipazione al capitale sociale.

ARTICOLO 10

Riduzione del Capitale della Società

10.1 L'azienda può ridurre il capitale sociale con decisione dell'Assemblea Generale. In ogni caso, il capitale sociale della società non può essere ridotto al di sotto del minimo richiesto dalla legge.

10.2 La riduzione del capitale tocca i soci in proporzione alla loro quota nel capitale, a meno che ai sensi della legge o dello statuto l'Assemblea Generale possa decidere diversamente.

ARTICOLO 11

Trasferimento di Quote del Capitale della Società

- Il contratto di cessione delle quote è stipulato per iscritto tra le parti.

- Il trasferimento delle azioni dei soci interni alla società o verso terzi esterni alla società è condizionato in ogni caso all'esercizio del diritto di prelazione a favore dei soci esistenti.

- Il socio, prima di trasferire sotto qualsiasi forma le sue azioni ad un altro socio esistente nella società o ad un altro soggetto esterno alla stessa, è tenuto a comunicare preventivamente per iscritto a tutti i soci esistenti se desiderano acquistare le azioni con la stessa condizioni economiche nonché proporzionalmente in base alle quote

përpjestimore sipas kuotave që zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

Në rast se të gjithë ortakët nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 ditëve nga njoftimi apo deklarojnë se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat ortakut është i lirë të transferojë kuotat e tij tërësisht apo pjesërisht personave të tretë.

KREU IV
Organet e Shoqërisë

NENI 12
Asambleja e Përgjithshme

Organi vendimmarrës i shoqërisë është **Asambleja e Përgjithshme.**

NENI 13
Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

possedute nel capitale della società.

- Nel caso in cui tutti i soci non rispondano per iscritto entro 20 giorni dalla notifica o dichiarino di non voler acquistare le quote, il socio è libero di cedere in tutto o in parte le sue quote a terzi .

CAPITOLO IV
Organi della Società

ARTICOLO 12
L'Assemblea Generale

Gli organi decisionali della società sono l'Assemblea dei Soci.

ARTICOLO 13
Diritti e obblighi del'Assemblea Generale

L'Assemblea Generale è responsabile di prendere decisioni per l'azienda in merito alle seguenti deliberazioni:

- la definizione e la politica aziendale dell'azienda;
- modifiche e statuto;
- nomina e revoca e amministratori;
- nomina e revoca e liquidatori autorizzati ed esperti contabili;
- determinazione e remunerazione, per amministratori, facilitatori ed esperti contabili autorizzati;
- supervisione e attuazione della politica commerciale da parte dell'amministratore, preparazione e rendiconti finanziari annuali e rendicontazione dell'attività economica;
- approvazione e bilancio annuale e rendicontazione dell'attività economica;
- aumento e diminuzione e capitale;

- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- largimin ose përjashtimin e ortakut;
- divisione e quote e cancellazione
- rappresentanza e società in giudizio e in giudizio e altri contro amministratori;
- riorganizzazione e disintegrazione e società;
- approvazione e regole procedurali delle riunioni assembleari;
- distribuzione e utili annuali e copertura e perdite;
- allontanamento o espulsione del partner.

NENI 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

14.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji dhe nga ky statut, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

14.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

14.4 Ortakët e shoqërisë janë të detyruar të depozitojnë me shkrim dhe regjistrojnë në Librin e Ortakëve, pranë administratorit të shoqërisë, adresën në të cilën do t'i dërgohet letra e porositur (rekomande) dhe adresën e postës elektronike. Njoftimet për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do të dërgohen në adresat e email-it të regjistruara në Librin e Ortakëve. Dërgimi i njoftimit në këto adresa do të konsiderohet si njoftim i kryer rregullisht.

14.5 Ortakët do të njoftohen për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me anë postës elektronike, e cila u dërgohet në adresën që rezulton nga Libri i Ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë.

ARTICOLO 14

Riunione e Assemblea Generale

14.1 L'Assemblea Generale si riunisce nei casi determinati dalla legge e dal presente statuto, ogniqualvolta l'assemblea sia necessaria per la tutela degli interessi della società.

14.2 L'Assemblea e l'Assemblea Generale sono convocate almeno una volta all'anno.

14.3 L'Assemblea Generale è convocata dagli Amministratori o da uno o più soci che rappresentano almeno il 5% (cinque per cento) del totale dei voti nell'Assemblea Generale.

14.4 I soci della società sono tenuti a depositare o inviare via mail e registrare nel Libro dei soci, presso l'amministratore della società, gli indirizzi di coloro che invieranno lettere e ordini. Gli avvisi per la riunione dell'Assemblea generale saranno inviati agli indirizzi mail di registrazione nel Libro dei soci. La consegna dell'avviso a questo indirizzo avverrà come avviso regolamentato.

14.5 I soci devono essere informati prima di 7 giorni della riunione dell'Assemblea Generale per e-mail all'indirizzo risultante nei libri di riunione e l'Assemblea.

14.6 L'avviso di convocazione deve contenere il luogo, la data, l'ora della riunione e l'ordine del giorno. Per il ritiro

14.6 Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Për tërheqjen e dokumentacionit që do të shqyrtohet në mbledhje ortakët mund t'i drejtohen me shkrim administratorit ose mund t'i tërheqin në selinë e shoqërisë.

14.7 Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së mësipërme ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët e shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje, dhe nepermjet video-konferencës, ose të përfaqësuar dhe janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë së thirrjes.

14.8 Asambleja do të quhet e vlefshme që në mbledhjen e parë. Në rast se një nga ortakët paraqet një kërkesë për shtyrje për një shkak të arsyeshëm, atëherë njoftimet për mbledhjen e radhës do të ripërsëriten sipas përcaktimeve të bëra më sipër.

14.9 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet në selinë e shoqërisë, në video-konferencë, ose në një vend tjetër të përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 15

Pjesëmarrja në Vendime

15.1 Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjesëtim me kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë.

15.2 Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme nga një ortak ose nga një person i tretë, në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

15.3 Ortaku nuk mund të përfaqësohet në Asamblesë e Përgjithshme nga Administratori.

della documentazione che effettua la revisione in assemblea dei soci è possibile contattare per iscritto l'amministratore oppure è possibile richiedere presso la sede dell'azienda.

14.7 Quando l'Assemblea Generale non è stata convocata nel modo sopra indicato, può prendere decisioni valide solo se tutti i soci della società sono presenti alla riunione (anche in videoconferenza) o rappresentati e accettano di prendere decisioni, nonostante l'irregolarità della convocazione.

14.8 L'assemblea sarà considerata valida dal primo incontro. Nel caso in cui uno dei soci presenti una richiesta di rinvio per un ragionevole motivo, le notifiche per il prossimo incontro verranno ripetute secondo le disposizioni sopra riportate.

14.9 La riunione dell'Assemblea Generale può essere tenuta presso la sede della società, in videoconferenza o in altro luogo da stabilire con decisione dell'Assemblea Generale.

ARTICOLO 15

Partecipazione alle Decisioni

15.1 Ogni socio ha diritto di voto in proporzione alla propria partecipazione al capitale sociale della società.

15.2 Qualsiasi socio può essere rappresentato nell'Assemblea Generale da un partner o da una terza persona, sulla base di una delega scritta. Tale autorizzazione può essere concessa solo per una riunione dell'Assemblea Generale, che comprende riunioni successive con lo stesso ordine del giorno.

15.3 Il socio non può essere rappresentato nell'Assemblea generale dall'amministratore.

NENI 16
Kuorumi

16.1 Për marrjen e vendimeve të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë më shumë se 51% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

16.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, anulimin e kuotës së kapitalit, largimin e ortakut dhe për të gjitha çështjet e tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti. Për këto çështje, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm personalisht ortakët që zotërojnë 75% të kapitalit të shoqërisë, dhe vendos me shumicë mbi 60% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 17
Procesverbali i Mbledhjes

17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

17.2 Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i mbledhjes cakton një mbajtës procesverbali, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit.

17.3 Procesverbalit i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

ARTICOLO 16
Quorum

16.1 Per le delibere di ordinaria amministrazione, l'Assemblea Generale è validamente costituita solo se partecipano i soci aventi diritto di voto che detengono più del 51% del capitale sociale. In questo caso, l'Assemblea Generale decide a maggioranza dei voti dei soci partecipanti.

16.2 Per le delibere di straordinaria amministrazione, tra le quali rientrano quelle per modificare lo statuto, aumento o diminuzione del capitale sociale, distribuzione degli utili, riorganizzazione e scioglimento della società, annullamento della quota capitale, allontanamento del socio e per tutte le altre questioni previste dalla legge, l'Assemblea Generale è validamente costituita se sono presenti i soci che rappresentano il 75% del capitale sociale e decide con la maggioranza dei soci che rappresentano il 60% del capitale sociale.

ARTICOLO 17
Verbale della Riunione

17.1 Tutte le decisioni dell'Assemblea Generale devono essere registrate a verbale. Il verbale contiene la data, il luogo della riunione, l'ordine del giorno, il nome del Presidente dell'Assemblea, il nome del Registratore, i risultati della votazione.

17.2 Per la redazione del verbale, il Presidente dell'Assemblea nomina un Responsabile del verbale, anche non socio. I verbali della riunione sono firmati dal Presidente dell'Assemblea e dal Responsabile dei verbali.

17.3 L'elenco dei partecipanti e l'annuncio della riunione dell'Assemblea Generale sono allegati al Verbale.



NENI 18
Administratori

18.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.

18.2 Shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm ose nga një këshill administrimi që përbëhet nga 3 ose 5 anëtarë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 1 vit me të drejtë ripërtëritje.

18.3 Administratori vetë personalisht ose me anë të përfaqësuesve të emeruar prej tij me prokurë përfaqësimi ka këto të drejta dhe detyra:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ARTICOLO 18
L'Amministratore

18.1 L'amministratore è l'organo esecutivo della società.

18.2 La società è amministrata da un amministratore unico oppure da un Consiglio di Amministrazione composto da tre o cinque membri. L'amministratore o il Consiglio di Amministrazione viene nominato e revocato dall'Assemblea Generale. La durata dell'incarico è di un anno con diritto di rinnovo.

18.3 L'Amministratore ha i seguenti diritti e doveri:

- Svolge tutti gli atti di amministrazione dell'attività commerciale della società, attuando le politiche commerciali, decise dall'assemblea generale;
- Rappresenta l'azienda;
- Cura la corretta ed ordinata tenuta dei documenti e dei libri contabili della società;
- Predisporre e firma il bilancio annuale, il bilancio consolidato e la relazione sullo stato di avanzamento delle attività e, unitamente alle proposte per la distribuzione degli utili, sottopone tali documenti all'approvazione dell'Assemblea Generale;
- Stabilisce un tempestivo sistema di allerta per le circostanze che minacciano il buon funzionamento dell'attività e l'esistenza dell'azienda;
- Esegue le registrazioni e invia i dati obbligatori dell'azienda, come previsto dalla legge per il Centro Nazionale di Registrazione;
- Riferisce all'Assemblea Generale in merito all'attuazione delle politiche commerciali e all'attuazione di azioni speciali di particolare rilevanza per l'attività dell'azienda;
- Conserva la rubrica degli indirizzi dei soci dell'azienda;
- E responsabile della conservazione delle



- mban librin e adresave të ortakëve të shoqërisë;
- përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

copie dei verbali delle riunioni dell'Assemblea Generale;

- Svolge altri compiti definiti dalla legge e dallo statuto

18.4 Administrator i vetem i shoqërisë është znj. Malvina Përgega, atësia Pashko, dhe mëmësia Majlinda, lindur në 14.12.1986 në Lezhë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 033548238 dhe nr. personal I66214047C e cila do të qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë 1 vjecare.

18.4 L'Amministratore Unico della società è la sig.ra Malvina Përgega, figlia di Pashko e Majlinda, nata il 14.12.1986 a Lezhë e residente a Tirana, titolare della carta di identità no.033548238 e numero personale I66214047C, che resterà in tale carico per un periodo di un 1 anno.

Administratori ka të drejtën e një shpërblimi dhe të një shumë monetare për mbulimin e shpenzimeve të ndryshme, vlera e të cilës do të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme për cdo vit.

L'amministratore avrà diritto ad un compenso e ad un rimborso spese che verrà stabilito dall'Assemblea Generale di anno in anno.

KREU V

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve

NENI 19

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

19.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

19.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

19.3 Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

NENI 20

Shpërndarja e Fitimeve

20.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

20.2 Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime

CAPITOLO V

Esercizio finanziario e bilancio annuale, distribuzione degli utili

ARTICOLO 19

Esercizio Finanziario e Bilancio Annuale

19.1 L'esercizio finanziario inizia il 1 ° gennaio e termina il 31 dicembre.

19.2 Il bilancio annuale, l'inventario, il rapporto sullo stato di avanzamento dell'attività e il rapporto del perito contabile autorizzato sono approvati dall'Assemblea Generale.

19.3 I documenti relativi al bilancio dell'esercizio devono essere approvati entro 6 (sei) mesi dalla chiusura dell'esercizio

ARTICOLO 20

Distribuzione dei Profitti

20.1 I soci hanno diritto a condividere la parte dell'utile dichiarata nel bilancio della società. L'utile viene distribuito ai soci in proporzione alle quote possedute, previa delibera dell'Assemblea dei Soci di

ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VI

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë, Largimi dhe Përfundimi i Ortakëve

NENI 21

Riorganizimi i Shoqërisë

Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 22

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

22.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Shoqëria nuk priset në rast humbje të zotësisë, apo vdekjes së njërit prej ortakëve.

22.2 Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

22.3 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 23

Largimi dhe Përfundimi i Ortakëve

23.1 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendim për largimin ose përfundimin

straordinaria amministrazione.

20.2 L'azienda può distribuire utili ai soci solo se dopo aver pagato i dividendi:

- il patrimonio della società copre integralmente le sue passività;
- la società dispone di disponibilità liquide sufficienti per estinguere le passività scadute entro i 12 mesi successivi.

CAPITOLO VI

Riorganizzazione della Società, Scioglimento e Liquidazione della Società, Rimozione ed Esclusione dei Soci

ARTICOLO 21

Riorganizzazione della Società

La società può essere riorganizzata fondendosi con un'altra società, oppure tramite scissione in due o più altre società o mediante trasformazione di una forma giuridica.

La riorganizzazione della società può essere effettuata solo su decisione dell'Assemblea Generale.

ARTICOLO 22

Scioglimento e Liquidazione della Società

22.1 La società si scioglie nei casi previsti dalla legge o per decisione dell'Assemblea Generale. La società non si interrompe in caso di perdita di capacità o decesso di uno dei soci.

22.2 In caso di scioglimento la società sarà soggetta a procedura di liquidazione.

22.3 Per la procedura di liquidazione della Società si applicherà la legislazione Albanese in vigore.

ARTICOLO 23

Rimozione ed Esclusione di Soci

23.1 L'Assemblea Generale può decidere di rimuovere o espellere un socio dalla società.

23.2 Për largimin ose përjashtimin e ortakut do të zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU VII

Dispozita të Fundit

NENI 24

24.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim.

24.2 Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 25

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ky Statut hartohet dhe firmoset në 4 (kater) kopje origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

23.2 Per l'allontanamento o l'espulsione del socio si applicheranno le disposizioni di legge della Legge n. 9901, del 14.04.2008, "Su commercianti e società".

CAPITOLO VII

Disposizioni Finali

ARTICOLO 24

24.1 Tutte le controversie tra i soci devono essere risolte amichevolmente.

24.2 Nei casi in cui non possono essere risolti amichevolmente, ciascuno dei soci ha il diritto di appellarsi alla Corte del Distretto Giudiziario di Tirana.


ARTICOLO 25

Per quanto non previsto nel presente Statuto, la Legge n. 9901, del 14.04.2008, "Su Commercianti e Società Commerciali", nonché la legislazione albanese in vigore.

Il presente Statuto è redatto e firmato in 4 (quattro) copie originali, tutte con lo stesso valore legale. Una copia è nella documentazione di base della Società.


ORTAKU I VETËM


Filippo Andresciani

FILIPPO ANDRESCIANI


SOCIO UNICO

Filippo Andresciani

FILIPPO ANDRESCIANI


U lexua dhe u përktheu
njo gjuna shqipe ne italisht
njo Molvime Rryzeze


Tiranë, 11 Qershor 2024